



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T
të mbledhjes urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa,
mbajtur më 16.07.2014, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Imer Rusinovci, Sami Hamiti, Hazir Borovci, Ylli Hoxha, Hatixhe Hoxha, Islam Pacolli dhe Cuneyd Ustaibo.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, Visar Berisha drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, Feti Mehdiu, Muhamed Selmani, (në cilësinë e vëzhguesit nga radhët e PDK-së), përfaqësuesi i INPO-së dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Feti Mehdiu**.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

REND I DITËS:

1. Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2014.

Mbledhjen e kryesoi **Feti Mehdiu**.

Ai tha se sa i përket rishikimit të buxhetit, kemi një afat shumë të shkurtër të dhënë nga Qeveria.

Kryetari, Shpend Ahmeti, lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2014, tha se jam përpjekur që të bëj sa më pak ndryshime, të cilat ndryshime janë në vlerë prej 4.000,000 €. Pagat i kemi ndarë prej pjesës tjetër të buxhetit për një arsye, sepse më 1 prill është bërë rritja e pagave për 25%, për të cilin qëllim Qeveria i ka marrë 15% nga buxheti, pozicioni mallra dhe shërbime, dhe i ka bartur në paga.

Në tabelë i kemi ndryshimet në dy katrorët e fundit, njëri tregon ku merret buxheti e tjetri ku orientohet ai buxhet.

Njëherësh ceku edhe dy shpenzime, për të cilat duhet të mendohet. Njëri ka të bëjë me vendimin e gjykatës për tërheqjen e shumës prej 1.6 milion € për çështje të pronës së palës Sanije Muqolli, por janë edhe dy vendime të gjykatës që kalojnë shumën 300.000€.

Ndryshim i madh është edhe te kompensimi i dëmeve të vërshimeve në komunën e Prishtinës, të cilin raport do ta prezantoj në mbledhje të muajit korrik.

Sa i përket arsimit, nuk kemi lëvizje, përveç tri projekteve për shkolla, ku janë paraqitur probleme dhe nuk mund të realizohen, andaj duhet të shikohet se si të realizohen, e këto janë:

1. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në lagjen "Kalabria", i cili nuk po lejohet të punohet, e që ka të bëjë me tokat e privatizuar, pra me pronarë të këtyre pronave.
2. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në lagjen "Arbëria", që është ndërprerë, sepse ka masa ndalese nga gjykata, ku është bërë ndërtimi i 70 m² në pronë private dhe janë tre pronarë të tokave.
3. Ndërtimi i objektit të ShMM "Prenk Jakova" është anuluar, sepse nuk është lokacioni i mirë. Qeverisja e kaluar e ka caktuar një lokacion në Breg të Diellit, ku janë të vendosura disa baraka të komunitetit rom. Ne jemi që të gjendet një lokacion i ri, ndërsa objekti i ShMM "Prenk Jakova" të bëhet aneks për shkollën fillore "Elena Gjika".

Po ashtu ceku se për qentë endacakë kanë qenë 50.000 € në buxhet, është dashur të shtohen edhe 50.000 €, sepse është kërkuar të ndërtohen katër strehimore për qentë endacakë, andaj është mirë në Kuvend të diskutohet për këtë çështje.

Në Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale kemi ndryshime. Ndërtimi i nënkalimit nga sheshi "Nënë Tereza" që lidhet me rrugën "Rexhep Luci", është anuluar ky projekt.

Zgjerimi i rrugës nga Fusha e Pajtimit deri në Grashticë - 4 korsi, 8 km, ky projekt nuk mund të realizohet gjatë këtij viti, sepse duhet të rrënohen disa shtëpi dhe të bëhet shpronësimi.

Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, kemi ndryshime. Projekti për Tregun e kombinuar, nuk mund të realizohet gjatë këtij viti.

Në Drejtorinë e Urbanizmit kemi ndryshime. Janë bartur 100.000 € për hartimin e planit rregullues.

Në Drejtorinë e Kadastrit dhe Gjeodezisë projekti "Krijimi i kadastrit të varrezave të qytetit", ka qenë i vlerësuar 50.000 €, këto mjete barten, sepse ky projekt nuk mund të realizohet gjatë këtij viti. Po ashtu edhe projekti "Krijimi i kadastrit të sinjalizimit vertikal të komunikacionit" dhe projekti "Rikonstruktimi i informacionit kadastral", nuk mund të realizohen gjatë këtij viti.

Për Teatrin e Qytetit të Prishtinës dhe për Muzeun e Eksodit, duhet të diskutohet më tutje, ndërsa për Sallën universale kulturore dhe Galerinë e qytetit, është mirë të vendoset në qendër, të diskutohet më tutje për këtë çështje.

Sami Hamiti tha se sa i përket rishikimit të buxhetit, kjo nuk po ndodh vetëm në këtë vit, por edhe vitin e kaluar ka ardhur një udhëzim administrativ që brenda 10 ditëve kalendarike të bëhet rishikimi i buxhetit, por gjithmonë vonohet 1-2 ditë, kështu që brenda 8 ditëve të bëhet rishikimi i buxhetit, kjo nuk është në rregull.

Sa i përket shumës totale në rishikim të buxhetit, shuma prej 4.200.000 €, është e pranueshme dhe është në kufijtë normal të një rishikimi të buxhetit.

Shumat i keni qitur në total, mirëpo nuk janë cekur në tabelë çdo pjesë që është hequr. Të përgatitet një aneks tabelë për kalkulimin e pagave dhe t'i bashkëngjitet rishikimit të buxhetit.

Te shpenzimet komunale do të kemi probleme, sepse do të jetë jo e favorshme bartja e 150.000 €, janë shumë.

Te projekti për zgjerimin e rrugës nga Fusha e Pajtimit deri në Grashticë, unë mendoj që të hiqet projekti dhe mjetet prej 600.000 € të mos barten, por të ndahen mjetet për pjesën e projektit, që projekti të jetë në vazhdimësi.

Për detyrimet nga aktgjykimet prej 1.600.000 € të gjenden alternativa.

Sa i përket kompensimit të dëmeve nga vërshimet, u interesua se a do të kompensohen vetëm personat e dëmtuar, apo edhe dëmtimet në infrastrukturë.

Kryetari, **Shpend Ahmeti**, tha të gjitha janë për kompensimin e dëmeve nga vërshimet.

Islam Pacolli shprehu mendimin se te infrastruktura lokale është mirë të vazhdohet më tutje, sa i përket parkingjeve të jenë publiko-private, shkollat të ndërtohet ashtu siç duhet. Për qentë endacakë duhet menduar për një zgjidhje adekuate.

Po ashtu tha se nuk është dashur të ndërtohen objekte të larta, pa u siguruar parkingjet nëntokësore.

Kryetari, **Shpend Ahmeti**, shpjegoi për parkingjet, duke marrë parasysh përvojat e shteteve në rajon. Ai ceku se do të jenë tri qendra të parkingjeve në Prishtinë, do të fillojnë me qendrën, po ashtu do të bllokojnë trotuaret me shtylla të vogla, që të mos shfrytëzohen për parkingje.

Ylli Hoxha shprehu shqetësimin për afatin e shkurtër të rishikimit të buxhetit.

Sa i përket qenve endacakë, propozoi që të bëhet një debat për këtë çështje.

Ai tha se do ta votojmë këtë propozimvendim, me shpresë që të merret më seriozisht çështja e buxhetit.

Muhamet Selmani (në cilësinë e vëzhguesit nga radhët e PDK-së), kërkoi të dijë se a do të shpenzohen të gjitha grandet qeveritare për projektet e ndryshme.

Kryetari, **Shpend Ahmeti**, tha se grandet qeveritare do t'i harxhojmë, sepse ato do të na tërhiqen.

Muhamet Selmani u shpreh se janë disa kërkesa nga qytetarët për disa projekte të vogla, që kishte me qenë mirë të futen në këto projekte, sepse nuk janë investime të mëdha.

Kryetari, **Shpend Ahmeti**, tha se këto kërkesa duhet të adresohen në Drejtorinë e Pronës dhe Financave.

Ymer Rusinovci theksoi se ky material është me nguti, mirëpo e përkrahim të shkojë më tutje ky propozimvendim për rishikimin e buxhetit të vitit 2014.

Cuneyd Ustaibo e përkrahu Propozimvendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2014.

Feti Mehdiu kërkoi të jetësohet sa më shpejt Rregullorja për trajtimin e qenve endacakë.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

Procesmbajtës :
Zijadin Gashi
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Feti Mehdiu